

Z. Klajdi Zylfi

Këshilltar

Z. Klajdi Zylfi ka lindur në Fier, më 18 maj 1990. Ai ka përfunduar studimet e tij universitare në Universitetin e Tiranës, në degën e Punës Sociale, si dhe ka kryer studime në degën e Drejtësisë në Universitetin Europian të Tiranës.

Në mars të vitit 2009, ai mori pjesë në një trajnim mbi "Planifikimin Familjar", duke e ndjekur këtë me një trajnim mbi "Komunikimin për Ndryshimin e Sjelljes në Planifikimin Familjar" në qershor të po atij viti.

Në shtator të vitit 2010, Z. Zylfi vazhdoi trajnimin në "Institutin e Trajnimit të Administratës Publike" dhe gjithashtu përfundoi një trajnim mbi "Exit Poll" lidhur me nxjerrjen e rezultateve paraprake të zgjedhjeve vendore në Tiranë.

Nga viti 2011 deri në 2017, Z. Zylfi ka mbajtur disa pozicione pune, duke përfshirë: Anketues në IDRA Research & Consulting, Specialist në Bashkinë Tiranë, Drejtorja e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Emergjencave Civile.

Që prej vitit 2019, Z. Zylfi ushtron detyrën e Këshilltarit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.